

K0221922

INTERNATIONAL CRIMINAL TRIBUNAL FOR THE PROSECUTION
 OF PERSONS RESPONSIBLE FOR SERIOUS VIOLATIONS
 OF INTERNATIONAL LAW COMMITTED IN THE TERRITORY
 OF THE FORMER YUGOSLAVIA SINCE 1991

DEKLARATA E DËSHMITARIT

TË DHËNA PËR DËSHMITARIN

Mbiemri: BERISHA**Emri:** Halit**Emri i babës:** Melit**Pseudonimi:****Gjinia:** Mashkull**Data e lindjes:** 5 gusht 1940**Vendi i lindjes:****Origjina etnike:** Shqiptar i Kosovës**Përkatësia fetare:** Musliman**Gjuh-a/ët e folura:** shqip dhe serbisht**Gjuh-a/ët e shkruara (të tjera nga ato të folura) :** shqip dhe serbisht**Gjuh-a/ët e përdorura gjatë intervistës:** shqip dhe anglisht**Profesioni i tanishëm:**

I papunë

I mëparshëm: Kryetar komune**Adresa:**

Rruga e Re Nr. 9 Suharekë, tel. 029 71 457

Data-t e intervist-ës/ave:

E premte 17 Gusht 2001, Kosovë

Intervistuesi: Stefen LEACH**Përkthyesi:** Ardiana SADIKOVIQ

Emrat e të gjithë personave të pranishëm gjatë intervistës: Hetuesi Stephen LEACH,
 përkthyesja Ardiana SADIKOVIC dhe dëshmitari Halit BERISHA

Berisha Halit/K020-8583-K020-8589.doc/db



K0221923

DEKLARATA E DËSHMITARIT

Unë quhem Halit BERISHA dhe jam 61 vjeç. Jam lindur në Suharekë, Kosovë. Jetoj në Suharekë me gruan time, gjashtë djemtë, tre prej tyre janë të martuar, ndërsa njëri është i fejuar, katër nipa dhe tri mbesa. Ky është rrathi im i ngushtë familjar. Familjarisht jam i lidhur me familjen BERISHA që është masakruar nga ana e policisë serbe më 26 mars të vitit 1999 përmes gjyshit tim, pra gjyshi im dhe gjyshi i tyre kanë qenë vëllezër.

Me 24 maj të vitit 1984 u zgjodha kryetar i komunës së Suharekës dhe në këtë pozitë isha deri më 5 prill të vitit 1991 kur edhe u largova dhunshëm nga zyra ime nga ana e kuvendit serb të Suharekës. Me këtë datë pesë serbë hynë në zyrën time. Tre ishin të shërbimit sekret të policisë dhe dy të tjerët ishin nga kuvendi serb, njëri ndër të cilët ishte Boban VUKSANOVIQ i njohur edhe si Bobek. Ai punonte si mjek në Suharekë dhe pasi unë u largova nga pozita e kryetarit, këtë pozitë e mori ai. Sidoqoftë me 14 prill të vitit 1999 ai u vra. Personi i dytë ishte Tomislav BORISAVLLEVIQ, sekretar në kuvendin serb të Suharekës. Në vijim janë rrethanat e largimit tim: Kur këta persona hynë në zyrën time ata më treguan një dokument në të cilin thuhej se ishte marrë një vendim nga ana e Kuvendit të Serbisë në Beograd për të larguar personat e përmendur në atë dokument nga pozitat dhe funksionet e tyre. Në këtë dokument figuronte edhe emri im. Aty ishte edhe një person tjetër me emrin Stanislav ANGJELKOVIQ i cili ka punuar pranë Drejtorisë së Mbrojtjes Civile. Këtë Stanislavin unë e kam njohur për 25 vite me rradhë si mësues në Suharekë. Ai gjithashtu ka punuar në komunë nën drejtimin tim deri në gusht të vitit 1990. Siç thashë edhe më parë unë isha kryetar komune deri me 5 prill të vitit 1991, sidoqoftë në gusht të vitit 1990 roli i policisë ndryshoi dhe atyre u kishte dhënë qeveria autorizimin për të përmbytur qeverisjen shqiptare. Në kohën kur u largova nga pozita e kryetarit mu mor edhe një revole e cila më ishte dhënë për vetëmbrojtje.

Prej datës 5 prill 1991 e deri me 8 tetor 1999 unë isha i papunë. Prej datës 8 tetor 1999 e deri më 11 nëntor 2000 kam punuar në Këshillin Administrativ të Komunës së Suharekës si




K0221924

nënkyrjetar i komunës deri në zgjedhjen e administratës së re me 28 tetor 2000 dhe pak kohë deri sa administrata e re u njoh me punën

Unë tash do t'ju shpjegoj ngjarjet deri dhe pas masakrimit të familjes BERISHA më 26 mars 1999. Me 24 mars 1999 kishte lëvizje shumë të madhe të forcave serbe të veshur me uniforma të ndryshme, përvèç forcave që ishin në qyte prej një farë kohe. Disa prej tyre kishin të veshur rroba kamuflazhi të zeza me të kuqe, në fakt ata kishin shami me ngjyra të ndryshme në kokë.. Të tjerët kishin të veshur uniforma kamuflazhi të policisë me ngjyrë të kaltër e disa të tjerët uniforma kamuflazhi me ngjyrë të gjelbër. Ata patrullonin nëpër rrugët e qytetit dhe serbët vendas të veshur me uniforma të policisë apo të ushtrisë iu bashkuan atyre. Të gjithë ishin të armatosur me automatik AK 47, ndërsa snajperistët ishin të vendosur në kulmet e ndërtesave. Disa prej tyre ishin të vendosur në kishë, e të tjerët në ndërtesën e postës. Këto forca shtinin në drejtim të popullatës shqiptare e cila lëvizte në qytet. Ne mund të lëviznim vetëm nëse lëviznim shumë afër ndërtesave dhe nuk dilnim jashtë pa pasur ndonjë gjë me rëndësi.

Me 25 mars 1999 rreth orës 0630, 20 deri në 30 anëtarë të familjes KUÇI dhe familjes së Ramadan BERISHËS, që jetonin në qendër të Suharekës kanë kaluar kah shtëpia ime që gjendet prapa ndërtesës së komunës. Më treguan se në lagjen e tyre kishte të vrarë dhe të plaçkitur dhe ata po iknin për të mos pësuar të njëjën gjë. Disa prej tyre ishin me papuçë dhe nuk kishin pasur kohë të ndërronin rrrobat prej frikës.

Unë i thashë familjes time t'i mblidhnin gjérat dhe të merrnim traktorin, rimorkion dhe veturat dhe të shkonin drejt lumit së bashku me familjet të cilat i përmenda më lart dhe të shkonin në fshatin Savrovë. Unë mbeta në shtëpi me gruan time dhe vëllain tim Jashar BERISHA (i lindur më 1943) i cili punonte si shef i pompës së benzinës që gjendet në qendër të Suharekës, prapa qendrës tregtare dhe bodrumit të verës, atje ku u masakrua familja Berisha. Më vonë, atë mëngjes Jashari shkoi në punë kundër dëshirës sime. Rreth orës 1700 Jashari erdhi në shtëpi dhe më tregoi se ende kishte lëvizje të madhe të forcave serbe nëpër



K0221925

qytet. Ai gjithashtu më tregoi se forcat serbe që ishin të vendosura në ndërtesën e postës kishin ardhur tek ai dhe kishin kërkuar alkohol, por ai nuk kishte patur.

Mëngjesin e nesërm, më 26 mars 1999 vëllai im shkoi prapë në punë në pompën e benzinës edhe këtë herë kundër dëshirës sime. Ai më tha mos të brengosesha sepse ai kishte kohë që punonte në pompën e benzinës dhe se atje ishte i sigurtë. Rreth orës 1220, atë ditë, Jashari më thirri në telefon dhe më tha: "ikni nga shtëpia sepse në qendrën tregtare janë duke vrarë njerëz", unë i thashë "edhe ti ik nga puna, ç'pret?". "Unë jam mirë dhe do të vij në shtëpi në orën 1700", tha ai. Unë i mblodha të gjithë fqinjët dhe fëmijët e tyre. Ishim gjithsej diku rrëth 200 vetë, unë shkova shtëpi për shtëpi për t'u thënë që të largoheshin. Ata që jetonin afër meje ishin të gjithë të familjes BERISHA. Ne shkuam te lumi dhe u fshehëm në kaçuba. Rreth orës 1430 pasdite shkova në një shtëpi në lagjen Gashi dhe prej aty i telefonova Jasharit i cili më tregoi se policia serbe kishte vrarë Sedatin, Nexhatin dhe Bujarin. Ai nuk kishte mundur ta shohë pjesën e qendrës tregtare ku ishin masakruar anëtarët e tjerë të familjes BERISHA, por më tha se kishte dëgjuar të shtëna, shpërthime dhe klithma nga drejtimi i qendrës tregtare. Unë i thashë përsëri që të largohej nga puna, por ai refuzoi dhe tha se do të kthehej në shtëpi në orën 1700. I telefonova Jasharit edhe një hënë në orën 1630 dhe ai tha se do të vinte në shtëpi në orën 1700.

U kthyem në shtëpinë e një kushëriri rrëth orës 1730, po atë ditë. Attje ishin dy shtëpi njëra afër tjetrës. Ne, burrat, shkuam në një shtëpi, ndërsa gratë shkuan në tjetrën. Burrat e mbikqyrnin edhe shtëpinë e grave në mënyrë që ato të ishin të sigurta. Unë vendosa të kthehesha në shtëpinë time dhe të shihja se si ishte Jashari po ai nuk ishte aty. I telefonova një familjeje serbe sepse ata jetonin afër pompës së benzinës dhe i pyeta se mos dinin gjë për Jasharin por ata më thanë se nuk mund të më ndihmonin dhe e myllën telefonin.

Me 27 mars 1999, në mëngjes, kushëriri im, gruaja ime dhe unë shkuam te një familje serbe për të marrë vesh se çfarë kishte ndodhur me Jasharin, por ata na thanë se nuk mund të na ndihmonin. U kthyem në atë shtëpinë ku qëndronim dhe pritëm tërë ditën.



K0221926

Me 28 mars, në mëngjes, rreth orës 1155 dëgjova një shpërthim dhe pashë se minarja e xhamisë ishte e shkatërruar. I telefonova një kushëriri që jetonte afër xhamisë i cili më tregoi se serbet e kishin hedhur në erë minaren e xhamisë. Kjo ndodhi ditën e Bajramit kur normalisht xhamia do të ishte përplot me shqiptarë. Rreth orës 1800 një fqinj serb vendas i cili ishte polic, nuk më kujtohet emri i tij, erdhi në shtëpinë tonë dhe na tha: "ju duhet të shkoni për në Shqipëri sepse paramilitarët do të vijnë dhe do t'ju vrasin". Unë dhe gruaja ime u larguam atë mbrëmje rreth orës 1900 në këmbë dhe shkuam në drejtim të fshatit Savrovë për t'u takuar me anëtarët e tjerë të familjes. Të tjerët përgatitën traktorët, rimorkiot dhe veturat dhe thanë se do të shkonin për në Shqipëri. Më vonë disa prej këtyre personave më treguan se disa prej tyreata ishin ndalur dhe ju ishin grabitur sende të çmuara nga ana e policisë. Kushëririt tim policia i mori veturën Opel Calibra me ngjyrë të kuqe.

Në fshatin Savrovë arritëm rreth orës 2100 dhe rrugës hasën njerëz nga Reqani të cilët gjithashtu ishin larguar prej shtëpive të tyre. Rreth orës 0630 të mëngjesit unë shkova në fshatin Buzhalë që është në komunën e Suharekës. Në shtëpinë ku qëndruam ishin rreth 130 persona dhe ne qëndruam atje deri me 3 prill 1999. Atë ditë u larguam për shkak të ofensivës që ishte ndërmarrë kundër këtij fshati. Familja ime shkoi për në Shqipëri. Mbas dy ditëve u takuam në Prizren. Policët na ndalën dhe na thanë që të ktheheshim në Savrovë ku qëndruam edhe dy ditë të tjera dhe prej andej shkuam në banesën e hallës/tezes sime në Suharekë. Unë shkova në mal me dy djemtë e mi më 7 prill, ndërsa anëtarët e tjerë, gjithsej 18, kanë mbetur në shtëpinë e hallës/tezes sime. Me 2 maj 1999 u ktheva në atë shtëpi dhe qëndrova aty. Unë nuk dilja por gruaja ime dhe kunata e saj shkonin në shtëpinë tonë për të marrë ushqim. Ajo më tregoi se shtëpia jonë ishte plaçkitur, si p.sh. kompjuteri, makina e qepjes, frigoriferi, teshat etj. Mobiljet ishin të thyera, biblioteka ime nuk ishte shkatërruar por sidoqoftë ishte bërë rrëmujë. Shtëpia e vjetër afër shtëpisë sonë ishte djegur, po ashtu ishte djegur edhe sana. Shtëpia e kushëririt tim, Asllan BERISHËS, ishte djegur tërësisht. Vetëm disa shtëpi u dogjën si p.sh. shtëpia e Sedatit, Ragipit, Bashkimit, Hamitit dhe Avdiut, të gjithë këta me mbiemrin BERISHA.




K0221927

Këtu qëndruam deri më 16 maj 1999, sidoqoftë më 15 maj djali im dhe gjashtë persona tjerë u kapën në një shtëpi nga policët, të cilët lajmëruan komandantin e Sigurimit Shtetëror Mishko NISHAVIQ. Pasi kishte ardhur ai e pyetur djalin tim për emrin dhe kur Mishko mori vesh djali i kujt, ai i tha djalit tim që të më thoshte se të nesërmen unë duhet të paraqitesha në Komunës. Unë vendosa të shkoja dhe u takova me Mishkon vetëm për të mos ma ndjekur familjen. Ai më dërgoi në stacionin e policisë dhe biseda me të zgjati vetëm 10 minuta. Aty ishte edhe kushëri im Hamiti, por biseda me të zgjati vetëm një minutë. Mishko më pyeti se ku kisha qenë dhe unë për të mbrojtur veten i thashë se kisha qenë në Prizren. Gjithashtu më pyeti edhe për djalin tim dhe disa të tjerë nga Suhareka se ku kishin qenë dhe ku ndodheshin në atë moment. Unë iu përgjigja dhe ai më tha se një organizatë humanitare do të vinte për të na ndihmuar dhe më kërkoi falje që më kishte dërguar në stacionin e policisë. Unë nuk u keqtrajtova aspak.

U kthyeva në shtëpinë e hallës/tezes dhe qëndrova aty deri me 21 maj 1999. Rreth orës 1020 gjashtë policë erdhën te dera kryesore dhe njëri shkoi prapa shtëpisë. Njëri prej atyre policëve ishte Sinisha ANDREJEVIQ i cili na tha: "keni vetëm 15 minuta për t'u larguar për në Shqipëri dhe këtë vend nuk do t'a shihni kurrë më". Unë i thashë "a është ky vendim i juaji apo vjen nga më lart?". Ai vetëm e përsëriti atë që e tha më parë dhe nuk shtoi më shumë. Ne morën 2 vetura dhe iu bashkuam kolonës së njerëzve me vetura. Ata të cilët nuk kishin mjete transporti paraqiteshin në qendër të qytetit ku serbët kishin rregulluar dy autobusë dhe dy kamionë për transportin e tyre. Ne shkuam në drejtim të Prizrenit e prej këtu në drejtim të Zhurit. Menjëherë në dalje të Prizrenit te fabrika farmaceutike ishin një polic dhe një ushtar. Ata kontrolluan letërnjoftimet tona. Disave ata ua morën letërnjoftimet, por neve jo.

Kur arritëm në vendkalimin kufitar në Morinë policia na i mori të gjithëve letërnjoftimet, patentat e shoferit, targat e vetravave. Kur arritëm në Kukës pamë se në kolonë ishim më shumë se 5000 vetë. Prej këtu na dërguan në kampe të refugiatëve dhe qëndruam aty deri më 23 qershor të vitit 1999, kur u kthyem në shtëpi.



K0221928

FM

Pak kohë pasi u ktheva nga Shqipëria në shtëpi, më 13 korrik 1999 mu dha rasti të shihja disketë e cila u gjet në kompjuter në një dyqan/zyrë në Suharekë. E hapa disketën dhe gjeta informata që kanë të bëjnë me mbiemra dhe hollësira personale të UJ-së e ardhur nga Serbia, në komunën e Suharekës, mbi njësitet, sektoret e personelit dhe mbi armët e zjarrit të dhëna këtij personeli.

SHIKO SHTOJCËN “A”

Pas 8 titorit të vitit 1999, kur fillova të punoja përsëri në komunë, gjeta dokumentet në vijim:

1. Kërkesën e Partisë Socialiste për t'i përashtuar të gjithë shqiptarët prej funksioneve dhe posteve.
2. Kërkesën e popullatës serbe për t'u pajisur me armë.
3. Listën e serbëve të armatosur në Njësitin e Kasapëve Romë
4. Listën e ekipit shoqërues.
5. Fotografinë e Sreqko ILIQ nga fshati Leshan.
6. Listën e anëtarëve të Mbrojtjes Civile.
7. Kërkesën e ndërmarrjes “Ballkan” për t'u pajisur me armë.
8. Vendimet e kuvendit për të ndërruar emrat e shkollave prej shqipes në serbisht.
9. Vendimin për të vërtetuar mandatet e këshilltarëve.
10. Vendimin e njësive zgjedhore për të zgjedhur këshilltarët në komunën e Suharekës.
11. Vendimin për të larguar nga vendi i punës sekretarin e Kryqit të Kuq në Suharekë.
12. Dokumentin zyrtar për dorëzimin e pompës së benzinës në Suharekë “Beopetrol”.
13. Kalendarin e shënuar më datën 25 mars 1999 të kryetarit të Këshillit Ekzekutiv Stanislav ANGJELKOVIQ me numrin e telefonit tim ku gjithashtu ishte i shënuar edhe numri i telefonit të vëllait tim Jasharit në punë. Në të njëjtën faqe pashë edhe emrin PLAZHINIQ i cili në atë kohë ishte prokurorë/gjykatës në Suharekë. Dorëshkrimin e identifikova si të Stanislav Angjelkoviqt.
14. Vendimin për të mbyllur shkollën e mesme.



K0221929

FM

15. Vendimin për të formuar një komision për të përcaktuar dëmet e shkaktuara nga bombardimet e NATO-s.

Unë kam mbajtur dokumentat origjinalë ,të cilët i kam gjetur.

SHIKO SHTOJCËN “B”.

Jam i gatshëm të paraqitem në gjyq dhe të tregoj për atë se çfarë kam parë dhe çfarë ka ndodhur.

Jam vënë në dijeni se deklarata ime mund t'u jepet institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit dhe/ose autoriteteve juridike për qëllime të ndjekjes penale. Me këtë pranoj që deklarata ime t'u lëshohet autoriteteve të tillë sipas gjykimit të Zyrës së Prokurorit

K0221930

VËRTETIM I DËSHMITARIT

Kjo deklaratë gjashtëfaqëshe, më është lexuar në gjuhën shqipe, dhe është e vërtetë me sa di dhe me sa më kujtohet. Këtë deklaratë e kam dhënë vullnetarisht dhe jam i vetëdijshëm që mund të përdoret gjatë procedurave ligjore para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Përndjekjen e Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar të kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991 dhe se mund të ftohem të dëshmoj publikisht para këtij Tribunali.

Nënshkrimi: /nënshkrim/


Data: 27 gusht 2001

VËRTETIM I PËRKTHYESIT

Unë , Ardiana SADIKOVIQ, përkthyes, vërtetoj se:

1. Jam e kualifikuar dhe e miratuar nga Sekretaria e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë Prej Viti 1991, për të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.

Berisha Halit/K020-8583-K020-8589.doc/db



K0221931

2. Më ka informuar Halit BERISHA se ai e flet dhe e kuption gjuhën shqipe.
3. Kam përkthyer me gojë deklaratën e mësipërme nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në praninë e Halit BERISHËS, i cili dukej se e ka dëgjuar dhe kuptuar përkthimin tim të kësaj deklarate.
4. Halit BERISHA ka vërtetuar se faktet dhe çështjet e paraqitura në këtë deklaratë, të përkthyer prej meje, janë të vërteta, me sa di dhe sa i kujtohet, dhe rrjedhimisht ka nënshkruar në vendet përkatëse.

Data: 27 gusht 2001

Nënshkrimi:/nënshkrim/

